



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**Komiteti për Politikë e Financa**

**I.Numër: 060/01-63019/22**

**Pejë, datë: 20 Qershor 2022**



**PROCESVERBAL**

Nga takimi i VI-të i Komitetit për Politikë e Financa i KK-së Pejë, mbajtur me 20 qershor 2022, në ora 13:00.

Takimi u mbajt në sallën e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pos anëtarëve të komitetit, në këtë takim prezantojnë: Kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, znj. Nita Panduri Drejtoresh e administrates , z. Nystret Hajrizi Drejtor Zhvillimit ekonomik, z. Januz Hajzeraj kordinator i menaxhimit të përfomances , z. Avni Gashi, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit, z. Egzon Kastrat Asistent Administrativ i Kryesuesit, përfaqesutit e OSBE –së dhe përfaqësuesit e ZIP-it.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, i cili konstatoj se jemi të gjithë anëtarët prezent. Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin ku paraprakisht tregoj paraprakisht një pike nga drejtoria e urbanizmit lidhur me mbjelljen e disa drunjeve të heket nga rendi i ditës sepse nuk është kompletu me dokumentacion dhe ne vend të kesaj kemi një pike shites për rendin e ditës si raport informativ lidhur me përfomance e komunës për periudhen janar-dhjetor 2021 dhe me pas i sqaroj të gjitha pikat të cilat janë vendos në rend ditës .

Unanimisht nga të gjithë prezent u miratua ky:

### **Rendi i Ditës**

- (1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.
- (2) Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë e Financa: dt. 20. Maj 2022.
- (3) Raportet dhe Rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e SHCK:
  - 3.1. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2023 – 2025.
  - 3.2. Shqyrtimi i Raportit informativ mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmit në Komunën e Pejës.
  - 3.3. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Pejës.
  - 3.4. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për ankesa lidhur me procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale në Komunën e Pejës.
  - 3.5. Shqyrtimi i Raportit informativ mbi performancën e Komunës së Pejës, për vitin Janar – Dhjetor 2021.
- (4) Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:

#### **I.**

**Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të komitetit dhe mungesa.**

Nuk pati.

## **II. Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i Komitetit për Politikë dhe Financa: dt. 20 maj 2022.**

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua procesverbali i takimit të Komitetit për Politikë dhe Financa i datës: 20 maj 2022.

### **III**

#### **3.1. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2023 – 2025.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: drejtori ka pas me qene prezent por për shkak të natyrës urgjent të një operimi që ka pas prindi i tij nuk ka mundur që të jetë prezent.

Z. Labinot Panxha: unë vetem deshta të ndalem të ujesjellsit i L. Baranit për vitin 2023 janë ndar 300 mij euro a mundet me u kry ky projekt me këto mjete edhe nese jo ather pse nuk janë nda mjete edhe për vitin 2024 dhe 2025 në menyr që me u kompletu ky projekt.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratimi, Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2023 – 2025.

#### **3.2. Shqyrtimi i Raportit informativ mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmit në Komunën e Pejës.**

Z. Nysret Hajrizi: duket e ditë që une në janar jam emerura si drejtor kemi pase një mori aktiviteteve sa i perket zhvillimit ekonomik e konkretisht turizmit, sa i perket aktiviteteve kemi pasë vizita të ndryshme neper biznese tu i shiku nevojat dhe mundësit për me ju ndihmi me u gjeneru nga pandemia covid 19. Sa i perket kornizes se projekteve të gjitha projekte që janë parapar për vitin 2021 janë kry krejt projektet e kemi vetem edhe një projekt me tenderu për me shumë mundemi me diskutu.

Z. Labinot Panxha: një pyetje për drejtorin a ka mujtë me i identifiku sfidat që i kanë pas bizneset gjatë periudhes se pandemis dhe a o ne dijeni që brenda një viti janë mbyll diku 2000 biznese a ka mujt me i identifiku cilët kanë qene shkaktaret pse janë mbyll ?

Z. Nysret Hajrizi: ne bazë të informatave që kemi pandemia ka goditur sektorin e gastronomisë na si komunë nuk kemi mundësi me ju ndihmu shumë, nuk kemi ndonjë arsye pse janë shuhe ka mundësi se prej pandemis por ka biznese që dojnë me shfrytezu këtë mundësinë e start-upit nga ana e qeverisjes por prapë po e them nuk kemi analizë të saktë pse janë mbyll.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim, shqyrtimi i Raportit informativ mbi zhvillimin ekonomik dhe turizmit në Komunën e Pejës.

### **3.3. . Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Pejës.**

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: këshillave lokalë ju përfundon mandati në këtë vit dhe duhet të formohet komision për zgjedhje të këshillave të ri ashtu siq e parasheh edhe rregullorja komunale. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë 4 janë nga kuvendi 1 nga ekzekutivi 1 nga shoqëria civile dhe 1 anëtar zgjedhet aty për aty nga bashkësia lokale.

Znj. Nita Panduri: është rregullorja 01-2021 që parasheh organizimin dhe bashkëpunimin e komunës së Pejës me fshatra dhe vendbanime, jemi model për zgjedhje në nivel vendi dhe kemi bashkëpunim konstruktiv me këto bashkësi zgjedhjet do të mbahen në shtator ose tetor ta shohim pas këtij komisioni vjen komisioni i ankesave.

Z. Berat Ganiqi : unë veq deshta me u nderlidh se ka shumë kryetar të bashkësive lokale që janë zgjedh edhe jone veq figura edhe personazhe, a ka me pas një raport për punën e tyre unë po flas për lagjen Rrokaqelli asgjë ska bo për atë lagje, ka mbetë lagja ma e pa zhvilluar si për nga mbeturina ashtu edhe për shkak të mungesës së tereneve sportive, kjo o pak e qëllimshe sepse partia në pushtet nuk merr vota andej për këtë arsye nuk ka investime.

Znj. Nita Panduri: procesi i zgjedhjeve është demokratik pra kryetar zgjidhen me votë dhe normalisht kur zgjidhet ai i përfaqëson edhe interesat e asaj bashkësie. Kësaj radhe megjëse i kemi 30 bashkësi lokale kemi me tentu që me i involvu edhe ma shumë gjinin femërore të shohim tash sa ka interesim nga ana e tyre.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: meqense se me heret unë jam marrë me këtë punë ather mund të them që bashkëpunimi i bashkësive lokale me konë ka qenë teper konstruktiv sa i përket detyrave dhe përgjegjësive ata janë të obligaur të mbajn takime më anëtarët e bashkesive lokale dhe te mbajnë procesverbal dhe ti dorëzon në komunë po ashtu sa i përket takimev publike dhe degjimeve buxhetore ata jepin kontribut përmes kërkesave dhe prioriteve qe kanë për ato lokalitete që i përfaqesojn sipas matjeve rreth 85 % e kërkesave të tyre janë marrë përbaz në buxhet. Secili kryetarë mundet të jetë simpatizus i ndonjë partie politike por jo të jetë anëtar i rregullt i ndonjë subjekti politk.

Z. Berat Ganiqi : unë spo thom që nuk ka bashkëpunim ka pr një kryetar që merr 31 vota nuk e përfaqeson lagjen Rrokaqelli, ai duhet me i ngrit qeshtjet qe preukopojn krejt lagjen edhe për mbeturina edhe për antena sepse në bazë të një analize cdo e treta shtëpi ka një te semur me kancer pra këto janë ceshtjet me interes publik që duhet me i adresu një kryetar bashkesie. Unë e di që zgjedhja bëhet mbi bazen e demokracis se kam votuar edhe unë vët por 31 votanuk janë as 0.1% e lagjes.

Z. Labinot Panxha: drejtoresha e tha që zgjidhen në menyrr demokratike po deshta me cekë sa janë produktiv sa merret më kërkesat e ati lokalitetit e bojn një raport që i listojn mbi bazën e prirotetev të bashkësis sepse ata po paguhen. Sepse partia në pushtet po tenton që ti zgjedh njerzit e vetë dhe jon disa që pahiri i kanë rreshit gjatë procesit sa merren parasysh kërkesat e tyre pra duhet që tash e tutje të paguhet kryetari që punon dhe ka raport te qartë të punës sepse ai paguhet diku 300 euro por spaku me ditë kush po punon e kush jo.

Znj. Nita Panduri: kta paguhen 300 euro dhe është një shumë qesharake që nuk i mbulon as shpenzimet minimale të tyre por ata paguhen në bazë të procesverbaleve që kanë të pjesa e dosjes si dokument mbeshtetes është edhe procesverbal. Kryetart e bashkësis lokale duhet të jenë aktiv për këtë e kanë marrë edhe detyren dhe pergjgjesinë. Ligji e parasheh se nese janë zgjedhur dy mandate radhazi mandatin e tretë smunden me u zgjedh po tash po e kqyrim qysh po zhvillohet procesi zgjedhor.

Znj. Hidajete Nikqi: a monitorohen takimet e tyre a vetem me proceverbal ?

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: nuk është e parapame me rregullore me u monitoru sepse ata dorëzojn procesverbale dhe nermalisht edhe të pjesa e degjimeve buxhetore shihet edhe angazhimi i tyre.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave lokale në Komunën e Pejës.

#### **3.4. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për ankesa lidhur me procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale në Komunen e Pejës.**

Kryesuesi Rexhep Kurtbogaj: komisioni përbëhet nga 3 anëtar dhe ka për detyrë që nese paraqitet ndonjë parregullesi gjatë procesit zgjedhor ather i merr dhe i shqyrton.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim dhe miratim, shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për ankesa lidhur me procesin e zgjedhjeve të Këshillave Lokale në Komunen e Pejës.

#### **3.5. Shqyrtimi i Raportit informativ mbi performancën e Komunës së Pejës, për vitin Janar – Dhjetor 2021**

Z. Januz Hajzeraj: raporti është vetem si informues, nese ju kisha pru raportin ai është dikun mbi 300 faqe dhe për momentin është në Ministri ku është tu u trajtu është konfidencial deri sa Ministria ta vlerëson pasataj hapet për publikun, raporti i performances përfshin dikun 19 fusha dhe janë 122 indikatorë ndërsa ne vitin paraprak kan qenë 119 për shkak të pandemise ku ka pasur disas indikatorë tendecioz për shembull të shëndetesia ti kërkohet pacientit përkatesia etni, janë 19 fusha përfshir shërbimet administrative , transparenca komunale , pergjegjshmeria komunale, kultura rini dhe sport, menaxhimi i fatkëqsive, planifikimi hapsinor komunal, transporti publik komunal, parkingjet publike, investimet në ujin e pijes,

rrjeti i kanalizimit, menaxhimi i mbeturinave, mbrojtja e mjedisit, shendetesia në kompetencat e komunës, zhvillimi ekonomik lokal, arsimi parauniversitar, shërbimet sociale dhe familjare, përfaqesimi gjinor në komunë. Për vitin 2020 komuna ka arritë grandin 761186.71 euro është grant i performances qe ipet nga Minsitria dhe organizata Demos shpresoj që këtë vitë kemi me dal ma mire jo për shkak qe unë kom ndonjë info por bazuar në indikatore qe i kemi futë në sistem dhe punës që është bo.

Znj. Drita Maloku: këtu deshta më pyet a është mungesa e kodit apo profesionisteve për vëndet e punës.

Z. Januz Hajzeraj: të shendetesia problemi nese jam i sakt është të mungesa e specializimeve .

Z. Berat Ganiqi : a mundesh me ditë fushat ku kemi dal keq si komunë.

Z. Januz Hajzeraj: kemi qene keq të transparenca komuanle, përgjegjshmeria, parkaingjet publike jo se kemi bo përmissim të madh po kemi një rritje konstant vitin e kaluar problemi ka qene edhe të futja e të dhënave në sistem, përshembull të prokuruimi ka qene e publikaur ne ëeb po është ngarkuar dokumenti gabim këtu kemi marrë pikë negative.

Z. Labinot Panxha : na krejt po dim qe janë 19 fusha tjera janë konfidenciale qëkaq po dim.

Unanimisht nga të gjithë anëtarët prezent i rekomandohet kuvendit për shqyrtim, shqyrtimi i Raportit informativ mbi performancën e Komunës së Pejës, për vitin Janar – Dhjetor 2021.

**(4) Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:**


Z. Berat Ganiqi: për here të dytë për ditë të clirimit nuk lëshohet hymni kombëtar veq ai shtetëror, e dyta dy asambleistev te mi u është bërë e padrejt i pari Feriz Gashi ka pas problemeve me drejtorin saqë edhe rasti o në polici edhe për Elenora Balen që ka fol në kuvend ju ka suspendu burii prej një komisioni atje, ne skemi me hesht gabim e keni ne kemi qene opozit konstruktiv por nese mendon që dikush me hakmarrje ka me na mbyll gojen gbim e keni, me u suspendu Gazmend Bala per hakmarrje o gabim me qindra keqëperdorime i ka bo drejtori i shendetesis po ju tregoj që të gjitha kemi me i qitë .

*Pjesë e këtij procesverbali është edhe audio incizimi i këtij takimi të Komitetit për Politikë dhe Financa.*

**Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime të tjera nuk pati, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të KPF-së në orën 14:00 h.**

**Procesmbajtësi,**

**z. Avni Gashi**



**KRYESUESI,**  
**z. Rexhep Kurtbogaj**

